Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e

qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula _____

Shtojca 8

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

****Shënim: Për kryerjen e verifikimeve përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në shtojcën 8, lutemi të plotësoni të dhënat për personin/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka**

kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

Emër, (1)	Atësi, (2)	Mëmësi, (3)	Mbiemër, (4)	Ditëlindje (5)
----------------------------	-----------------------------	------------------------------	-------------------------------	---------------------------------

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);

b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;

c. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 5/1;

ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;

d. Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit për operatorin ekonomik, sipas standardit ndërkombëtar ISO 9001 ose ekuivalent. Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 18001 ose ekuivalent. Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuar të bilanceve të viteve: 2017, 2018, 2019 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

2.3 Për kapacitetin teknik:

1. Operatori Ekonomik për produktet nr. 1,2,3,4,5 të tabelës nr. 1, duhet të paraqesë :

- **Mostra**
- **Autorizim Prodhuesi dhe/ose Kontratë Furnizimi/Bashkëpunimi nga një Distributor i Autorizuar në të cilat, duhet të jenë përcaktuar emërtimet e produkteve dhe kodi i prodhimit për secilin produkt Autorizimi apo Kontrata duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit apo kontraktuesit (Distributor i Autorizuar) si: telefon, fax, e-mail, website. Në rast paraqitje autorizim nga distributor i autorizuar prej prodhuesit, operatori duhet të paraqesi në letër angazhim ose akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre si dhe cdo dokumentacion shkresor provues që vërteton lidhjen me prodhuesin të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuar me origjinalin.**
- **Skedat teknike të cilat mund të jenë pjesë përbërëse e produktit, ose si dokumentacion shoqërues i tij të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuara me origjinalin, të cilat duhet të përmbajë karakteristikat teknike të produktit, ato duhet të jenë lehtësisht të verifikueshme në faqen zyrtare të prodhuesit, kjo në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike.**

2. Per artikullin me nr. 6 Hipoklorit Natriumi në tabelen nr. 1, duhet të paraqesë Raport Analize nga ISHP (Instituti i Shendetit Publik) .

3. Per artikullin Nr.7, 8 në tabelen nr. 1 të paraqitet vetem moster .

Tabela nr. 1

Nr	Emertimi
1	Solucion lares xhami 5 lit
2	Lares Enesh 5 Lit
3	Solucion pastrimi Sgrasatore (moster 5 Lit)
4	Sapun Likuid per duar (moster 5 Lit)
5	Pastrues Dyshemeje Pllakash (moster 5 Lit)
6	Hipoklorit Natriumi 13-15 % (moster 1 lit)

7	Leter higjenike (pako 6 rulon)
8	Leter higjenike e palosur per duar

4. **Diten e Hapjes se ofertave OE duhet te paraqese nga nje moster për produktet e e tabelës se mesiperme per te provuar pajtueshmërinë me standardet e kërkuara sipas skedave teknike te tyre dhe specifikimet teknike te vendosura ne DST . Dorezimi i mostrave të paraqitet në ambjentet e UMT-së, në datën dhe orën e hapjes së ofertave.**
5. **Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me ane te se ciles merr persiper te kryeje shërbimin e transportit, te te gjithë artikujve ne adresat e autoriteteve kontraktore, te perfshira ne kete procedure prokurimi**
6. **Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë të punësuar për periudhën 3-mujore Qershor 2020 - Gusht 2020, një staf punonjësish prej minimalisht 2(dy) persona. Për stafin e punonjësve ofertuesi duhet të paraqesë:**
 - a) **Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore lëshuar nga administrata tatimore;**
 - b) **Listëpagesat e deklaruarat në organet tatimore për periudhën Qershor 2020 - Gusht 2020**

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Nr	Emertimi	Specifikimet teknike	Njesi
1	Aparate dezinfektimi me kapacitet 1 liter	Aparate dezinfektimi duarsh qe vendoset ne murë, kapacitet 1 litër	cope

Dokumentat Standarde të Tenderit

2	Termometër digjital infrared	Sipas Udhëzimit të Përbashkët Nr. 294, datë 06.05.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Të realizojë matjen e temperaturës së trupit të njeriut në një distancë matjeje 3-5 cm; të ketë diapazon matje 32° - 42.9 °C ose 89.6 °F- 109.2 °F; me rezolucion 0.1° C/0.1° F; në lagështi relative ≤90%; Saktësia sipas standartit ASTM E1965-1998 (2003) ose ekuivalent: - 30 - 34.9°C (±0.3C) - 35 - 42°C (±0.2°C) - 42.1 - 42.5°C (±0.3°C).Termometri të ketë mundësi ushqimi me bateri te cilat shoqerojne aparatin; Të ketë çertifikimin CE ose FDA ose ekuivalent. Aparati duhet te shoqerohet me 4 pako bateri rezerve.	cope
3	Maska pelhure	Sipas Udhëzimit të Përbashkët Nr. 294, datë 06.05.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me tre shtresa ,kapja me llastik te veshet dhe pas koke, qepje me cilesi, ngjyra sipas kerkeses se A.K.	cope
4	Maska nje perdorimshme Vetem per personelin)	Maskë kirurgjikale e thjeshtë, me një përdorim, me lidhëse pas veshit ose pas kokës, të mbrojnë hundën dhe gojën, me përshtatës për hundën, të mos shkaktojë probleme me frymëmarrjen, të ketë përshkueshmëri të mirë të ajrit, me nivel filtrimi të ajrit ≥99%, hipoalergjike, me copë të pathurur me 3 shtresa me palosje, cellulozë, poliestër, fibër, me formë drejtkëndëshe e sheshtë, me nivel të mirë mbrojtjeje, me dimensione 90mm x 180mm (±10mm). Afati i skadencës të jetë të paktën 1 vit nga koha e furnizimit. Të ambalazhuara në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes.	cope
5	Doreza	Latex pa puder, josterile, njëpërdorimshe, në masat M-L, , paketim 100 copë , sipas Udhëzimit te perbashket nr 294 date 06.05.2020 te Agjencise se Prokurimit publik dhe Ministrise se Shendetsise	Pako
6	Xhel dezinfektant për duar	Sipas Udhëzimit të Përbashkët Nr. 294, datë 06.05.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Me paketim plastik 500 ml-1000ml vetem 200 copet e para, (për përdorim nga punonjësit brenda zyre), pjesa tjetër me paketim 4-5 lit - 10 lit max	lit

Dokumentat Standarde të Tenderit

7	Dezinfektues për sipërfaqe me minimum (për mobilje, doreza dyersh, tastiera, telefona, xhama etj)	Sipas Udhëzimit të Përbashkët Nr. 294, datë 06.05.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Me paketim plastik dhe me tapë për sprucim, 500ml -1000 ml vetem 200 copet e para (për mobilie, doreza dyersh, tastiera, telefona, xhama, etj.), pjesa tjetër 4-5 lit-10 lit max	lt
8	Dezinfektues për sipërfaqe me minimum për parmak, dysheme etj	Sipas Udhëzimit të Përbashkët Nr. 294, datë 06.05.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Me paketim plastik me minim 1000 ml vetem per 200 copet e para (për parkakë, dysheme, etj.)pjesa tjetër 4-5 lit-10 lit max	lt
9	Alkol etilik i denatruar	Sipas Udhëzimit të Përbashkët Nr. 294, datë 06.05.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Me paketim plastik me spruco 1000 ml vetem 500 copet e para (për përdorim nga punonjësit brenda zyre) pjesa tjetër 4-5 lit-10 lit max., me përqëndrim 70% - 95%, antiseptik, dezinfektues për përdorim të jashtëm, me veprim dezinfektues me spektër të gjerë veprimi ndaj viruseve, bakterieve, grameve, et.	lt
10	Dizifektues / higjenizues per banjo (Acid klorhidrik,)	Acid klorhidrik 50 % I përqëndruar. Pastrues për banjot, pllakat, muret. Përdoret si: Gërryes, hidhet direkt në sipërfaqen për pastrim dhe shplahet me ujë. - pastrim banjo - hollohet në varësi të shkallës së papastërtisë. Rregullues i Ph: Të aplikohet direkt. Përdorni gjithmonë dorezat. Të mos përdoret së bashku me produkte të tjera me bazë klori sepse çlirohen gazra të dëmshme. Ambalazhimi ne bidona plastik 1 liter	cope
11	Pastrues per tualete (Gel, Pulirapid)	Perdoret per disinfektimin e banjove dhe ambjenteve te tjera te nevojshme si dhe per aksesore inox te tualetve, paketimi - bidon 1-2.5 lit. Të jetë linjë profesionale. Niveli I PH - (1-2)	lt
12	Aromatik WC cilesore plastike te mbushura me liquid	Janë aromatizues në formë likuide të cilat vendosen në anën e WC ose brenda në kasetën e WC.	cope
13	Aromatik ambjentesh me timer	Aparat aromatizues ambientesh (zyrash) (bombula). Të jenë të bardha dhe plastike.	cope

Dokumentat Standarde të Tenderit

14	Aromatik cilesor SPRAY per aparate me timer	Aromatizues ambientesh (zyrash) (bombula). Të përmbajë 5% surfaktanti jo/jonik, parfum, acid laktik.	cope
15	Hipoklorit natriumi (Klor i lenget ose Ace 1 li)	Me paketim plastik minimumi Perdoret per disifektimin e banjove dhe ambjenteve te tjera te nevojshme, paketim me bidon plastik 2 liter.ose 2.5 lit.	lt
16	Klor i lenget xhel	Solucion të lëngshëm për larje të thellë. Bazë klori dhe të fortë për larjen e porcelaneve dhe pllakave. Niveli I PH 1+- (10%) në 20 gradë C, me viskozitet <20 cSt, paketim me bidon plastik 2 liter.ose 2.5 lit.	lt
17	Solucion lares xhami	Pastrues i lëngët për xhama me sprucim dhe sipërfaqe të lëmuara, shumë ekonomik në përdorim. Pastron përsosmërisht, nuk lë gjurmë dhe thahet shpejt. përshtatshëm për kristale, pasqyra, vitrina, ekrane, stenda, laminata, aparate elektrike, paketim me bidon plastik 750 ml ± 50 . Të jetë prodhim me standarte CE, i certifikuar. Të ketë aromë të lehtë. Të jetë linjë profesionale.	cope
18	Larës enësh	Solucion larje enësh lëng, paketim plastik. Të jetë aktiv, cilësor në larjen e yndyrnave, të jetë i ambalazhuar me enë plastike 1 liter deri ne 5 litra. Ambalazhimi të jetë bërë nga fabrika dhe të ketë analizën spektrale në ambalazhim.	lt
19	Pluhur lares	pluhur lares per rroba te bardha	kg
20	Solucion pastrimi sgrasatore	Pastrues i lenget universal per siperfaqe e njolla te veshtira per tu pastruar, perdoret per siperfaqe te ngurta e te buta, paketimi 750 ml, me sprucim. Perdoret duke sprucuar mbi sferfaqen e ndotur, vepron per pak minuta e me pas shpelahet duke e fshire.	cope
21	Solucion per larje parketi	Solucion I lenget me arome per pastrim te dyshemeve te drurit dhe mobilje, perdoret duke hedhur sasi te solucionit ne ujin e larjes se dyshemese antimikrobik. Paketimi bidona plastik min. 5 lit, max 10 lit	llt
22	Pastrues dyshemeje/pllakash	Pastrues aromatik i përdorimit të përgjithshëm, neutral, me aromë të lehtë që vazhdon gjate. I përshtatshëm për vende higjienike, zyra, klasa, dhoma zhveshje, palestra dhe kudo ku ka probleme ere të pakëndshme, paketim me bidon plastik 1 liter deri ne 5 litra.	lt

Dokumentat Standarde të Tenderit

23	Pastrues mobiljesh	Pastrues neutral me pak shkumë, i përshtatshëm për pastrimin e mobiljeve dhe zyrave ne zyra e auditore, me sprucim 300 ml	cope
24	Sapun likuid për duart	Sipas Udhëzimit të Përbashkët Nr. 294, datë 06.05.2020 të Agjensisë së Prokurimit Publik dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Me paketim plastik 500 ml Perdoret per pastrim human (duar etj.), me parfume, e butë për lëkurën dhe e testuar dermatologjikisht.	cope
25	Sapun liquid per duart 5 litra	Sipas Udhëzimit të Përbashkët Nr. 294, datë 06.05.2020 të Agjensisë së Prokurimit Publik dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Sapun liquid për duart. Amballazhimi të jetë në bidona nga 5 litra. Të jetë I certifikuar, të ketë kartat e sigurisë dhe të përbërjes. Të jetë antibakterial dhe të ketë aromë të lehtë. PH 6+-5%	cope
26	Sapun tualeti i ngurte	Te jene me paketim dhe pesha e nje cope te jete jo me e vogel se 200 gram	cope
27	Bishta per fshesa 120 cm (metalik), me fileto te gjere	Shkop metalik 120 cm, profesional, me fileto te gjere, te sigurt ne mekanizmin montues dhe shume rezistent.	cope
28	Shtupa pastrimi pambuku per shkopa me fileto te gjere	Shtupa me perberje tekstili te dendur per pastrimin e dyshemeze 200-250gr, me koke plastike te filetuar per tu kapur ne bisht, per shkopa me fileto te gjere, me perberje fijesh ne forme fitili, te mbushura te plota.	cope
29	Shtupa pastrimi mikrofiber me fije te trasha me ngjyra per shkopa me fileto te gjere	Tufa (shtupa) për larje dyshemeje, mikrofibër, 100% ekologjike të plota. Fijet të jenë në shirita me përmasa 25x4 cm +- 2 cm të mbushura plot.	cope
30	Furce banjo + mbajtese	Furce me fije plastike per pastrimin e WC ngjyre te bardhe	cope
31	Sfungjere per lavamane	Sfungjere per lavamane me njeren ane qe te jete e ashper. Pako me 3 cope	pako
32	Doreza plastike te trasha	Doreza plastike te trasha, cilesore, per lageshtire dhe papasterti, me ngjyre. Të kenë qëndrueshmëri të fortë me material që nuk dëmtohet lehtë dhe elastik, shumë përdorimshe.	palë
33	Fshesa pastrimi per shkopa me fileto te gjere	Fshesa shumengjyreshe me fije plastike, shume rezistente, me fileta, per shkopa me fileto te gjere, me gjatësi të fijos nga 5 - 7 cm, per ambiente te brendshme	copë
34	Fshesa gomine per pastrimin e ujit	Fshesa gomine per pastrimin e ujit 60 cm - 70 cm.	copë

Dokumentat Standarde të Tenderit

35	Kaci (lopate) plehrash plastike me bisht 1 meter	Lopate plastike per heqje plehrash te cilat jane te pajisura me nje bisht te gjate i cili montohet pingul me kacine plastike.	cope
36	Kanace plastike	Kanaçe plastike të masës 500 - 1000 ml me dorezë	cope
37	Kosha per mbeturina plastik me lartesi rreth 60 cm dhe diameter rreth 40 cm	Kosha per mbeturina plastik me lartesi rreth 60 cm dhe diameter rreth 40 cm, me kapak qe komandohet me kembe.	cope
38	Kova + shtrydhse	Kova plastike për larje dyshemeje, me vend për shtrydhje tufë. Të jenë shumë rezistente dhe praktike. Të ketë të etiketuar në pamjen e jashtme shenjën e kujdesit, kapacitet 12-14 litra. Përmasat 35x26x35 cm.Te thjeshta	cope
39	Shtupa tharese parketi + shkop	Shtupa me perbërje mikrofibre per tharjen e parketit	cope
40	Shtupa tharese pa shkop	Shtupa me perbërje mikrofibre per tharjen e parketit	cope
41	Leter higjenike e palosur per duar	Leter duarsh zik-zak me permasa 21x22cm, 300 gr pako, pako me 200-210 fije, ngjyrë e bardhë, që vendosen në aparatet e tyre,	pako
42	Leter higjenike rulon per duar	Leter higjenike per duar me 2 fije, 300 - 400 gr pakoja, pako me 2 rulone	pako
43	Leter higjenike (rulon)	Leter higjenike per banja me 3 fije, 400 gr. 125 metra /ruloni, pako jo me pak se 10 rulone	pako
44	Leter higjenike rulon	Leter higjenike me pako 6-10 rulon me peshe 4000 gr/pako	pako
45	Peceta pastrimi mikrofiber	Peceta pastrimi pako 3 copeshe, per fshirje pluhurash, me përmasa 30x30. Të jenë material 100% pambuku.	cope
46	Peceta pastrimi treshe	Peceta të zakonshme pastrimi set me 3 copë. Përmasat: 18x20 cm, ngjyra të ndryshme. Materiali: i sfungjertë 100% fibër natyrale.	cope
47	F.V. Shenja orientuese me boje rezistente	Boje rezistente ndaj faktoreve natyrore, ne forme hapash	cope
48	F.V. Shenja orientuese adeziv me d = 10 cm	+	cope
49	Sinjalistika horizontale per te mbajtur rradhen	Me adeziv, rrethore, d = 330 mm, ngjyre e verdhe, te kete mbishkrim " QENDRO KETU "	cope
50	Pantofla/ Shapka Nr.36.37.38 dhe 40	Pantofla prej materiali plastik, të sheshta dhe me taban që nuk rrëshket në lagështirë	pale
51	Perparese doku me mende te shkurtera, te bardha, nr. te ndryshem	Përparëset e dokut duhet të jenë prej materiali të bardhë me përbërje 100% pambuk, të jenë me mëngë të shkurtra.	cope

Dokumentat Standarde të Tenderit

52	Qese plehrash të mëdha 100 x 67 cm	Qese plastike te zeza per kosha te medhenj, rezistente, permasat 100 cm x 67 cm, pako me 10 cope qese	pako
53	Qese plehrash të vogla 60 x50 cm	Qese plastike te zeza per kosha te vegjel, rezistente, permasat 60 cm x 50 cm, pako me 10 cope qese	pako

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Emertimi	Njesi	Sasi Total	Sasite e kerkuara nga Institucionet			
				F.M	F.M.D.	F.SH.M.T.	Rektorati
1	Aparate dezinfektimi me kapacitet 1 liter	cope	85		5	80	
2	Termometër digjital infrared	cope	13	10	-	3	
3	Maska pelhure	cope	1,500		1,500		
4	Maska nje perdorimshme (Vetem per personelin)	cope	8,600		5,600	3,000	
5	Doreza	Pako	200	100	100		-
6	Xhel dezinfektant për duar	lt	1,740	250	350	1,100	40
7	Dezinfektues për sipërfaqe me minimum (për mobilje, doreza dyersh, tastiera, telefona, xhama etj)	lt	1,800	50	250	1,400	100
8	Dezinfektues për siperfaqe me minimum për parmak,dysheme etj	lt	1,930	100	40	1,790	-

Dokumentat Standarde të Tenderit

9	Alkol etilik i denatruar	lt	3,020	300	250	2,370	100
10	Dizifektues / higjenizues per banjo (Acid klorhidrik,)	cope	120	30	25		65
11	Pastrues per tualete (Gel, Pulirapid)	lt	265	100	10	100	55
12	Aromatik WC cilesore plastike te mbushura me liquid	cope	139			100	39
13	Aromatik ambjentesh me timer	cope	10			10	
14	Aromatik cilesor SPRAY per aparate me timer	cope	140			100	40
15	Hipoklorit natriumi (Klor i lenget ose Ace 1 li)	lt	300	100			200
16	Klor i lenget xhel	lt	270		30	240	
17	Solucion lares xhami	cope	165	100	10	30	25
18	Larës enësh	lt	41	21			20
19	Pluhur lares	kg	10		10		
20	Solucion pastrimi sgrasatore	cope	55		15		40
21	Solucion per larje parketi	llt	10		10		
22	Pastrues dysHEMEJE/pllakash	lt	118	60			58
23	Pastrues mobiljesh	cope	40	10			30

Dokumentat Standarde të Tenderit

24	Sapun likuid për duart	cope	340	80	10	150	100
25	Sapun liquid per duart 5 litra	cope	56		30	10	16
26	Sapun tualeti i ngurte	cope	100	80			20
27	Bishta per fshesa 120 cm (metalik), me fileto te gjere	cope	390	250	40	100	
28	Shtupa pastrimi pambuku per shkopa me fileto te gjere	cope	240	180	60		-
29	Shtupa pastrimi mikrofiber me fije te trrasha me ngjyra per shkopa me fileto te gjerë	cope	170			120	50
30	Furce banjo + mbajtese	cope	5		5		
31	Sfungjere per lavamane	pako	194	34		110	50
32	Doreza plastike te trasha	palë	270	20	50	150	50
33	Fshesa pastrimi per shkopa me fileto te gjere	copë	190	50	20	120	
34	Fshesa gomine per pastrimin e ujit	copë	6	6			
35	Kaci (lopate) plehrash plastike me bisht 1 meter	cope	35	25		10	
36	Kanace plastike	cope	10			10	
37	Kosha per mbeturina plastik me lartesi rreth 60 cm dhe diameter rreth 40 cm	cope	15	10			5

Dokumentat Standarde të Tenderit

38	Kova + shtrydhse	cope	38		8	30	
39	Shtupa tharese parketi + shkop	cope	5		5		
40	Shtupa tharese pa shkop	cope	10		10		
41	Leter higjenike e palosur per duar	pako	641	141		400	100
42	Leter higjenike rulon per duar	pako	540	100	90	300	50
43	Leter higjenike (rulon)	pako	585	245	90	250	
44	Leter higjenike rulon	pako	60				60
45	Peceta pastrimi mikrofiber	cope	380	200	50	100	30
46	Peceta pastrimi treshe	cope	120			100	20
47	F.V. Shenja orientuese me boje rezistente	cope	30			30	
48	F.V. Shenja orientuese adeziv me d = 10 cm	cope	500			500	
49	Sinjalistika horizontale per te mbajtur rradhen	cope	300			300	30
50	Pantofla/ Shapka Nr.36.37.38 dhe 40	pale	14			10	4
51	Perparese doku me mence te shkurtera, te bardha, nr. te ndryshem	cope	10			10	
52	Qese plehrash të mëdha 100 x 67 cm	pako	1,100	250		700	150
53	Qese plehrash të vogla 60 x50 cm	pako	550	250		300	

Afatet e lëvrimit: **5 (pesë) ditë nga data e nenskrimit te kontrates.**

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR³

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< Emri >

³ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 13

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj.____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikant e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specififikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezultojnë një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
